<p>1. Personi i licencuar për mbledhjen, grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, mbledh dhe grumbullon mbeturinat prej prodhuesit dhe zotëruesit dhe i transporton deri tek objekti në të cilin bëhet administrimi i mbeturinave.</p> <p>2. Mbeturinat e rrezikshme, paraprakisht klasifikohen sipas llojeve, mbledhen, grumbullohen dhe transportohen.</p> <p>3. Mbeturinat transportohen në mënyrë të përshtatshme me atomjete adekuate, për të mos ardhur deri tek shkapërderdhja, rënia dhe rrjedhja e tyre.</p> <p>4. Nëse ndotja ndodhë gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthejë në gjendje të mëparshme.</p> <p>5. Nëse mbeturina e transportuara, nuk pranohet në vendin e destinuar, transportuesi duhet ta kthejë mbeturinën në vendin ku është marrur.</p>	<p>1. A licensed person for collecting, accumulation and shipment of waste, collects and gathers the wastes from manufacturers and owners and shipment them to the facility where is performing the waste management.</p> <p>2. Hazardous wastes, preliminarily should be classified by species, then shall be collected, accumulated and shipment of waste.</p> <p>3. Wastes must be transported in a proper way with proper equipments, not to come to squander and to fall down or flow.</p> <p>4. If contamination occurs during shipment of waste, the transporter is obliged that contaminated place to return in earlier condition.</p> <p>5. If transporting waste, is not accepted in destination place, the transporter must return the waste to the place where was taken.</p>	<p>1. Lice licencirano za sakupljanje otpada, odlaganje i transport otpada, sakuplja i odlaže otpad od proizvođača i vlasnika i transportuje ga do postrojenja u kojem se vrši upravljanje otpadom.</p> <p>2. Opasan otpad, prethodno se klasifikuje prema vrsti, sakupljaju, nagomilovaju i transportuju se.</p> <p>3. Otpad mora da se transportuje na pravilan način odgovarajućim sredstvima, da ne bi došlo do njohovog razbacivanja, pada i curenja.</p> <p>4. Ako dođe do zagađenja tokom trasporta otpada, prevoznik je dužan da zagađeno mesto vrati na prvobitno stanje.</p> <p>5. Ako se transportovani otpad ne prihvati na mestu odredišta, prevoznik mora da ga vrati na mesto odakle ga je preuzeo.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 26 Trajtimi i mbeturinave</p> <p>1. Trajtimi i mbeturinave bëhet në pajtim me dispozitat e këtij Ligji dhe kushteve të përcaktuara në licencë.</p> <p>2. Trajtimi i mbeturinave bëhet sipas metodave fiziko-kimike, biologjike dhe termike.</p> <p>3. Trajtimi i mbeturinave bëhet sipas parimeve dhe prioriteteve për administrimin e mbeturinave.</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Waste treatment</p> <p>1. Waste treatment shall be done in accordance with the provisions of this Law and conditions determined in the license.</p> <p>2. Waste treatment can be made by following methods physical-chemical, biological and thermal.</p> <p>3. Waste treatment shall be done according to the principles of waste management.</p>	<p style="text-align: center;">Član 26 Tretman otpada</p> <p>1. Tretman otpada obavlja se u skladu sa odredbama ovog Zakona i uslova utvrđeni licencom.</p> <p>2. Tretman otpada vrši se u skladu sa fizičko-hemijskim, biološkim i termičkim metoda.</p> <p>3. Tretiranje otpada obavlja se na osnovu načela i prioriteta za upravljanje otpadom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 27 Trajtimi fiziko-kimik</p> <p>1. Trajtimi fiziko- kimik i mbeturinave përfshinë metodat: neutralizimin, mineralizimin, sodifikimin ose kripëzimin, oksidimin, reduktimin, absorbimin dhe adsorbimin, destilimin, shkëmbimi jonik, osmozën reverzibile dhe procese të tjera fiziko-kimike, nëpërmjet të cilave bëhet zvoglimi i karakteristikave të rrezikshme të mbeturinave.</p> <p>2. Trajtimi i mbeturinave sipas paragrafit 1. të këtij neni bëhet në bazë të kushteve të përcaktuara në licencë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 27 Physic-chemical treatment</p> <p>1. Physical-chemical treatment of waste includes methods such as neutralizing, mineralizing, salting, oxidation, reduction, absorption, distilment, ionic exchange, reversible osmosis and other physical and chemical processes, through which comes to the reduction of hazardous characteristics of wastes.</p> <p>2. Waste treatment under paragraph 1. of this article is based on the terms set in the license.</p>	<p style="text-align: center;">Član 27 Fizičko-hemijski tretman</p> <p>1. Fizičko-hemijski tretman otpada obuhvata metode: neutralizacije, mineralizacije, solidifikacije, oksidacije, redukcije, adsorpcije i destilizacije, jonske izmene, reverzibilne osmoze i drugih fiziko-hemijskih procesa kojim se smanjuju opasne karakteristike otpada.</p> <p>2. Tretman otpada prema stavu 1. ovog člana vrši se na osnovu uslova utvrđenih licencom.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 28 Trajtimi biologjik</p> <p>1. Trajtimi biologjik i mbeturinave është proces i zbërthimit të mbeturinave organike të biodegradueshme me qëllim të përfitimit të materialeve të dobishme, energjisë dhe zvogëlimit të ndikimeve negative në mjedis.</p> <p>2. Trajtimi biologjik i mbeturinave sipas paragrafit 1. të këtij neni bëhet me metodën e zbërthimit aerob ose anaerob për përfitimin e kompostit ose energjisë.</p> <p>3. Trajtimi i mbeturinave sipas paragrafit 1. të këtij neni bëhet në bazë të kushteve të përcaktuara në licencë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 28 Biological treatment</p> <p>1. Biological waste treatment is a process of degradation of organic waste in order to benefit bio-degradation of useful materials, energy and reduction of environmental impacts.</p> <p>2. Biological Waste Treatment in paragraph 1. of this article done method of aerobic or anaerobic degradation for the benefit of compost or energy.</p> <p>3. Waste treatment under paragraph 1. of this article is based on the terms set in the license.</p>	<p style="text-align: center;">Član 28 Biološki tretman</p> <p>1. Biološki tretman otpada je proces razgrađivanja biorazgradivog organskog otpada radi dobijanja korisnih materijala, energije i smanjenja negativnog uticaja na životnu sredinu.</p> <p>2. Biološki tretman otpada prema stavu 1. ovog člana vrši se aerobnom ili anaerobnom razgradnjom za dobijanje komposta ili energije.</p> <p>3. Tretman otpada prema stavu 1. ovog člana vrši se na osnovu uslova utvrđenih licencom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 29 Trajtimi termik</p> <p>1. Trajtimi termik i mbeturinave bëhet në bazë të dispozitave të këtij Ligji dhe kushteve të përcaktuara në licencë.</p> <p>2. Trajtimi termik i mbeturinave bëhet në impiante të cilat janë të projektuara, ndërnuara dhe të pajisura në bazë të këtij ligji dhe ligjeve tjera.</p> <p>3. Djegia e mbeturinave bëhet për përfitimin e</p>	<p style="text-align: center;">Article 29 Thermal treatment</p> <p>1. Thermal treatment of waste is based on the provisions of this Law and conditions specified in the license.</p> <p>2. Thermal waste treatment proceeds in the plants that are designed, built and equipped according to this law and other laws.</p> <p>3. Burning of wastes proceeds only for</p>	<p style="text-align: center;">Član 29 Termički tretman</p> <p>1. Termički tretman otpada vrši se na osnovu odredaba ovog Zakona i uslova utvrđenih licencom.</p> <p>2. Termički tretman otpada vrši se u postrojenjima koja su projektovana, izgrađena i opremljena u skladu sa ovim i drugim zakonima.</p> <p>3. Spaljivanje otpada vrši se za dobijanje</p>



<p>energjisë vetëm në rastet kur djegia është ekonomikisht e arsyeshme dhe kur energjia shtesë për djegien e mbeturinave përdorët vetëm për të nisur djegien ose kur mbeturinat shfrytëzohen si karburante.</p> <p>4. Zotëruesi, para se t'i djeg mbeturinat, siguron egzaminimin e veçorive të rrezikshme të mbeturinave.</p> <p>5. Operatori i impiantit nga paragrafi 2. i këtij neni, para se t'i djeg mbeturinat verifikon mbeturinat e pranura për djegie, se cilit lloj i përket mbeturinat, sasinë dhe veçoritë e tyre, kontrollon dokumentacionin përcjellës dhe sipas nevojës bënë mostrimin dhe egzaminimin e mbeturinave.</p> <p>6. Operatori në impiantin për djegien e mbeturinave është i detyruar të ruaj mostrat e mbeturinave së paku dy (2) muaj pas djegies së mbeturinave.</p> <p>7. Qeveria me akt nënligjorë përcakton kushtet dhe kriteret për trajtim termik, caktimin e lokacionit për impiant, kushtet teknike dhe teknologjike për projektimin, ndërtimin pajisjeve dhe kushtet e punës së impiantit si dhe çështje të tjera të rëndësishme për funksionimin e impiantit për trajtimin termik</p>	<p>gaining of energy power only when combustion is economically feasible and when extra energy is used for burning waste just to start burning waste or used as fuel.</p> <p>4. Prior of burning waste, a waste holder must provide examination of the characteristics of hazardous waste.</p> <p>5. Prior of burning waste plant operator under paragraph 2. of this article, must verify the received waste for incineration, to which the waste type belongs, quantity and their features, to check the accompanying documentation and as necessary to do sampling and examining characteristics of hazardous waste.</p> <p>6. Plant operator of burning waste is obliged to preserve the samples of burning wastes at least two (2) months after the burning of waste.</p> <p>7. Government through a sub-legal act defines conditions and criteria for thermal treatment, determining the location of plant, technical and technological requirements for the design, construction and equipments and also working conditions of plant and other issues important to the functioning of the plant for</p>	<p>energije samo u slučajevima kada je sagorevanje ekonomski opravdano i kada se dodatna energija za sagorevanje otpada koristi samo za početak paljenje ili kada se otpad koristi kao gorivo.</p> <p>4. Pre spaljivanja otpada vlasnik treba da obezbedi egzaminaciju osobina opasnog otpada.</p> <p>5. Pre spaljivanja otpada operater postrojenja iz stava 2. ovog člana, treba da primljeni otpad za spaljivanje proveriti kojoj vrsti otpada pripada, količinu i njihove osobine, da kontroliše prateću dokumentaciju i prema potrebi vrši uzorkovanje i egzaminaciju osobina opasnog otpada.</p> <p>6. Operater u postrojenju za spaljivanje otpada dužan je da čuva uzorke otpada najmanje dva (2) meseca nakon spaljivanja otpada.</p> <p>7. Vlada podzakonskim aktom određuje uslove i kriterijume za termički tretman, određivanje lokacije za postrojenje, tehničke i tehnološke uslove za projektovanje, izgradnju i uslove rada postrojenja kao i druga značajna pitanja za funkcionisanje postrojenja za termički</p>
---	--	---



<p>të mbeturinave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 30 Ripërdorimi dhe përpunimi i mbeturinave</p> <p>1. Mbeturinat, kur ka mundësi duhet të ripërdoren apo përpunohen si lëndë e parë sekondare dhe si lëndë për përfitim të energjisë.</p> <p>2. Mbeturinat që shfrytëzohen si lëndë e parë sekondare, mbledhen, transportohen dhe magazinohen të klasifikuara sipas llojeve.</p> <p>3. Produktet e përfituara nga përpunimi i mbeturinave, duhet të mos shkaktojnë ndikime negative në mjedis dhe për shëndetin e njeriut.</p> <p>4. Mbeturinat që mund të ripërdoren dhe përpunohen, nuk duhet të digjen ose deponohen, pa lejen e Ministrisë, me përjashtim të mbeturinave për të cilat ekziston arsyeshmëria ekonomike dhe të cilat nuk e rrezikojnë mjedisin dhe shëndetin e njeriut.</p> <p style="text-align: center;">Neni 31 Riciklimi i mbeturinave</p> <p>1. Mbeturinat, kur është e mundur riciklohen me qëllim që të përdoren si lëndë e parë</p>	<p>thermal treatment of waste.</p> <p style="text-align: center;">Article 30 Reusing and waste processing</p> <p>1. Waste, where it's possible should be reused or processed as a secondary raw material and as fuel for energy gain.</p> <p>2. Waste used as secondary raw material, are collected, transported and stored classified by species.</p> <p>3. Products derived from processing wastes, should not cause negative impacts on the environment and human health.</p> <p>4. Wastes that can be reused and processed, should not be incinerated or disposed, without the permission of the Ministry, with the exception of wastes for which there is economic justification and which do not endanger human health and the environment.</p> <p style="text-align: center;">Article 31 Waste recycling</p> <p>1. Waste, where possible should be recycled processed with aim of using them as a</p>	<p>tretman otpada.</p> <p style="text-align: center;">Član 30 Ponovno korišćenje i obrada otpada</p> <p>1. Otpad, kada je moguće treba da se ponovo koriste ili obrade kao primarna sirovina i kao sirovina za dobijanje energije.</p> <p>2. Otpad koji se koristi kao sirovina za prvu ili drugu namenu, sakuplja se, transportuje i skladišti klasifikovana prema vrsti.</p> <p>3. Proizvodi dobijeni iz obrade otpada, treba da ne prouzrokuju negativne uticaje na životnu sredinu i ljudsko zdravlje.</p> <p>4. Otpad koji se može ponovo iskoristiti ne treba se spaljivati ili skladištiti, bez dozvole Ministarstva, izuzev otpada za koje postoji ekonomski razlog i koje ne rizikuju životnu sredinu i ljudsko zdravlje.</p> <p style="text-align: center;">Član 31 Riciklaža otpada</p> <p>1. Otpad, kada je moguće treba se reciklirati radi upotrebe kao sekundarna</p>
---	--	--



<p>sekondare.</p> <p>2. Mbeturinat e ricikluara të cilat përdoren si lëndë e parë sekondare, mbledhen, klasifikohen në lloje, transportohen dhe magazinohen.</p> <p>3. Ndalohet përzierja e mbeturinave të rrezikshme me lloje të tjera të mbeturinave.</p> <p>4. Produktet e përfituara gjatë riciklimit të mbeturinave, duhet të mos shkaktojnë ndikime negative në mjedis dhe për shëndetin e njeriut.</p> <p>5. Mbeturinat që mund të riciklohen nuk mund të deponohen ose digjen pa lejen e Ministrisë, me përjashtim të mbeturinave për të cilat ekziston arsyeshmëri ekonomike dhe të cilat nuk e rrezikojnë mjedisin dhe shëndetin e njeriut.</p>	<p>secondary raw material.</p> <p>2. Waste used as secondary raw material, collected, transported and stored classified by species.</p> <p>3. Its prohibited mixing of hazardous waste with other types of wastes.</p> <p>4. Products derived from processing waste, should not cause negative impacts on the environment and human health.</p> <p>5. Wastes that can be reused and processed, can not be incinerated or disposed without the permission of the Ministry, with the exception of waste for which there is economic justification and which do not endanger human health and the environment.</p>	<p>sirovina.</p> <p>2. Reciklirani otpad koji se koristi kao sekundarna sirovina, sakuplja se, klasifikuje u vrste, transportuje i skladišti.</p> <p>3. Zabranjuje se mešanje opasnog otpada sa drugim vrstama otpada.</p> <p>4. Proizvodi dobijeni tokom recikliranja otpada, ne smeju da prouzrokuju negativne uticaje na životnu sredinu i ljudsko zdravlje.</p> <p>5. Otpad koji se može reciklirati ne treba se skladištiti ili spaljivati bez dozvole Ministarstva, sa izuzetkom otpada za koje postoji ekonomska opravdanost i koji ne ugrožavaju životnu sredinu i ljudsko zdravlje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 32 Magazinimi i mbeturinave</p>	<p style="text-align: center;">Article 32 Waste storage</p>	<p style="text-align: center;">Član 32 Skladištenje otpada</p>
<p>1. Mbeturinat magazinohen në vende teknikisht të përgatitura për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave.</p> <p>2. Mbeturinat që ruhen përkohësisht, klasifikohen sipas llojeve dhe veçorive të tyre.</p>	<p>1. Waste will be stored in countries that are technically prepared for temporary storage of waste.</p> <p>2. Waste that kept temporarily, classified according types and their characteristics.</p>	<p>1. Otpad se skladišti na tehnički opremljenim mestima za privremeno čuvanje otpada.</p> <p>2. Otpad koji se privremeno čuva, klasifikuje se prema vrsti i karakteristikama.</p>



<p>3. Mbeturinat e rrezikshme ruhen në magazina të veçanta për mbeturina të rrezikshme.</p> <p>4. Afati për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave nuk mund të jetë më i gjatë se tre (3) vite.</p> <p style="text-align: center;">Neni 33 Deponimi i mbeturinave</p> <p>1. Deponimi i mbeturinave në deponi bëhet sipas kushteve të përcaktuara me licencën për administrimin e mbeturinave dhe sipas standardeve për deponitë.</p> <p>2. Mbeturinat, duhet të deponohen në deponitë e lejuara.</p> <p>3. Deponitë e mbeturinave ndahen në:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. deponi për mbeturinat e rrezikshme;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.2. deponi për mbeturinat jo të rrezikshme;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.3. deponi të mbeturinave inerte.</p> <p>4. Qeveria, me akt nënligjor, përcakton kushtet për administrimin e deponive dhe licencimin e operatorit të deponive, procedurat e pranimit të</p>	<p>3. Hazardous waste must be stored in special warehouses for dangerous wastes.</p> <p>4. Deadline for temporary preserving waste can not be longer than three (3) years.</p> <p style="text-align: center;">Article 33 Waste disposal</p> <p>1. Storage of waste in the landfill proceeds where there is an adequate condition for waste management under the principle of waste hierarchy.</p> <p>2. Waste, must be disposed in permitted landfills.</p> <p>3. Waste landfills are divided into:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. landfill on hazardous waste;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.2. landfill on non-hazardous waste;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.3. landfill of inert wastes.</p> <p>4. The Government determine by the sub-legal acts, conditions for landfill administration and licensing operator the</p>	<p>3. Opasan otpad čuva se u posebna skladišta za opasan otpad.</p> <p>4. Rok za privremeno čuvanje otpada ne može biti duži od tri (3) godine.</p> <p style="text-align: center;">Član 33 Odlaganje otpada</p> <p>1. Odlaganje otpada u deponije vrši se prema uslovima utvrđenih u licenci za upravljanje otpada i prema standardima za deponovanje.</p> <p>2. Otpad, treba da se skladišti u dozvoljenim deponijama.</p> <p>3. Deponije otpada dele se na:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. deponije za opasan otpad;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.2. deponije za neopasan otpad;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.3. deponije za inertni otpad.</p> <p>4. Vlada posebnim podzakonskim aktom, utvrđuje uslove za upravljanje deponijama i licenciranje operatera deponije, procedure</p>
--	---	--



<p>mbeturinave, mënyrën e kontrollit të aktiviteteve, monitorimin e fazave operuese, procedurat e mbylljes dhe përkujdesjen pas mbylljes së deponive.</p> <p>5. Qeveria me akt nënligjor, përcakton kriteret për zgjedhjen e lokacionit të deponive dhe magazinave për ruajtjen e mbeturinave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 34 Administrimi i mbeturinave komunale</p> <p>1. Mbeturinat komunale duhet të mblidhen, grumbullohen trajtohen dhe administrohen në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe dispozitave tjera ligjore për rregullimin e veprimtarive komunale.</p> <p>2. Ministri, me akt nënligjorë, përcakton kushtet dhe rregullat për administrimin e mbeturinave nga sipërfaqet publike.</p> <p>3. Mbeturinat komunale të përziera me mbeturina të rrezikshme, duhet të ndahen kur ekziston llogaria ekonomike, në të kundërtën konsiderohen mbeturina të rrezikshme.</p> <p>4. Amvisëritë dhe prodhuesit tjerë të mbeturinave komunale detyrohen që mbeturinat e tyre t'i hedhin në vende të</p>	<p>landfills, waste acceptance procedures, method of control activities, monitoring the operational phases, closing procedures and care after the closure of landfills.</p> <p>5. The Government by the sub-legal acts determine criteria for selecting the location of landfills and warehouses for the storage of waste.</p> <p style="text-align: center;">Article 34 Municipal waste management</p> <p>1. Municipal waste should be collected, treated and managed in accordance with the provisions of this Law and other legal provisions that regulate local activities.</p> <p>2. Minister by sub-legal act, determine the terms and conditions for waste management of public spaces.</p> <p>3. Municipal waste mixed with hazardous waste should be divided when there is economic account, otherwise will be considered as hazardous waste.</p> <p>4. Households and other municipal waste producers are obliged to throw their garbage in certain places for collection of municipal</p>	<p>prihvatanja otpada, način kontrole aktivnosti, praćenje u operativnih faza, procedure zatvaranja i briga nakon zatvaranja deponije.</p> <p>5. Vlada posebnim podzakonskim aktom utvrđuje kriterijume za izbor lokacije deponija i deponija za čuvanje otpada.</p> <p style="text-align: center;">Član 34 Upravljanje komunalnim otpadom</p> <p>1. Komunalni otpad treba se sakupljati, odlagati, tretirati i upravljati u skladu sa odredbama ovog Zakona i drugih zakonskih odredaba za uređenje komunalnih delatnosti.</p> <p>2. Ministar, podzakonskim aktom utvrđuje uslove i pravila za upravljanje otpadom sa javnih površina.</p> <p>3. Komunalni otpad izmešan sa opasnim otpadom, treba se razdvojiti kada je ekonomski isplativo, u suprotnom, taj otpad smatra se opasnim.</p> <p>4. Domaćinstva i drugi proizvođači komunalnog otpada dužni su da se njihov otpad odlaže u mestima određenim za</p>
---	--	--



<p>caktuara për grumbullimin e mbeturinave komunale, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në vendet e caktuara për to.</p> <p>5. Komunat janë të detyruara të organizojnë sistemin për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme.</p> <p>6. Amvisëritë dhe prodhuesit tjerë të mbeturinave komunale, janë të detyruar të bëjnë ndarjen e mbeturinave në lloje, sipas kushteve të përcaktuara nga autoriteti kompetent, me qëllim të trajtimit dhe riciklimit të tyre.</p> <p>7. Komunat me akt të veçantë, rregullojnë sistemin dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit, orarin për mbledhjen e mbeturinave, llojin, numrin dhe mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnerëve për mbeturina, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen mbeturinat dhe mënyrat për transportim të mbeturinave komunale.</p> <p>8. Administrimi i mbeturinave komunale nga komuna duhet të bëhet përmes kontratave të veçanta me një apo më shumë operator publik ose privat të licencuar për administrimin e mbeturinave.</p>	<p>wastes, whereas hazardous wastes shall be divided and delivered at designated places for them.</p> <p>5. Municipalities are obliged to organize system for collection, and voluminous collected waste.</p> <p>6. Households and other municipal waste producers are obliged to do separation of waste types, defined by the competent authority for the purpose of treating and recycling them.</p> <p>7. Municipalities with special act regulate and conditions the manner of collection system, separation, procesing and recycling, waste collection schedule, type, number and manner of distribution and deployment of containers for garbage, maintenance of places where garbage is collected and the manner of transporting wastes.</p> <p>8. Municipal waste management by municipalities will be done through special contracts with one or more public or private operators who shall be licensed persons for waste management.</p>	<p>odlaganje komunalnog otpada, dok opasan otpad razdvoje i dostave na za to određenim mestima.</p> <p>5. Opštine su dužne da organizuju sistem prikupljanja i odlaganja masivnog otpada.</p> <p>6. Domaćinstva i drugi proizvođači komunalnog otpada, obavezni su da odvoje otpad po vrsti, prema uslovima koju utvrdi nadležni organ, u cilju tretmana i njeno ricikliranje.</p> <p>7. Opštine posebnim aktom, regulišu sistem i uslove o način prikupljanja, odvajanja, obradu i recikliranje, vreme za prikupljanje otpada, vrstu, broj i način razdeljivanja i postavljenja kontejnera za otpad, održavanje mesta gde se odlaže otpad i načini za transport komunalnog otpada.</p> <p>8. Upravljanje komunalnim otpadom opštine treba obaviti prema posebnim ugovorima sa jednim ili više javnih ili privatnih operatera koji trebaju biti lica licencirana za upravljanje otpadom.</p>
--	--	--



<p>9. Dy e më shumë komuna me marëveshje, sipas nenit 15 paragrafi 2. të këtij Ligji, përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet lidhur me sigurimin e kushteve për administrimin e mbeturinave, për shfrytëzimin e objekteve për deponim, për përpunimin dhe magazinim të mbeturinave, të drejtat dhe detyrimet e ndërmarrjeve publike për administrimin e mbeturinave, mënyrën e marrjes së vendimeve në rastet e ankesave për çështjet specifike që kanë të bëjnë me administrimin e mbeturinave, si dhe çështje tjera të rëndësishme për organizimin dhe administrimin e mbeturinave.</p>	<p>9. Two or more municipalities with the agreement under article 15 paragraph 2. of this Law, can determine the rights and obligations associated with providing waste management conditions, the use of storage facilities ,for waste procesnig and storage of waste, the rights and obligations of public companies for waste management, the manner of making decisions in cases of complaints on specific issues dealing with waste management, and other issues important to the organization and management of waste.</p>	<p>9. Dve ili više opština ugovorom prema članu 15 stav 2. ovog Zakona određuju prava i obaveze u vezi sa obezbeđenjem uslova upravljanja otpadom, za korišćenje objekata za odlaganje, obradu i skladištenje otpada, prava i obaveze javnih preduzeća za upravljanje otpada, način donošenja odluke u slučaju žalba za specifične slučajeve koji se odnose na upravljanje otpadom, kao i druga pitanja od značaja za organizovanje i upravljanje otpadom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 35 Administrimi i mbeturinave të rrezikshme</p>	<p style="text-align: center;">Article 35 Hazardous waste management</p>	<p style="text-align: center;">Član 35 Upravljanje opasnim otpadom</p>
<p>1. Mbeturinat e rrezikshme ndahen në bazë të karakteristikave të cilat i bëjnë ato të rrezikshme, në përputhje me Listën H, Shtojca III. e këtij ligji.</p> <p>2. Qeveria, me propozimin e Ministrisë, me akt nënligjor, përcakton rregullat e grumbullimit, ndarjes në lloje, magazinimit, transportimit, trajtimit, deponimit, ambalazhimit dhe paketimit të mbeturinave të rrezikshme.</p> <p>3. Ndalohet deponimi i mbeturinave të rrezikshme, pa u bërë trajtimi paraprak, me</p>	<p>1. Hazardous Waste Characteristics are divided according to which make the dangerous waste, in accordance with Schedule H of Annex III of this law.</p> <p>2. The Government, by the proposal of the Ministry, by the legal act, determine rules of collection, type's separation, storage, transportation, treatment, disposal, labeled and packaged hazardous wastes.</p> <p>3. Prohibited is the storage of hazardous, waste without prior treatment, with aim to</p>	<p>1. Opasan otpad odvaja se na osnovu karakteristika koji čine otpad opasnim, u skladu sa Listom H. Dodatak III. ovog zakona.</p> <p>2. Vlada na predlog Ministarstva, podzakonskim aktom utvrđuje pravila sakupljanja, odvajanja u vrste, magaziniranja, transporta, tretmana, deponiranja ambalažiranja i paketiranja opasnog otpada.</p> <p>3. Zabranjeno je odlaganje opasnog otpada bez prethodnog tretmana u cilju</p>



<p>qëllim për të zvogëluar përqëndrimin e komponenteve të dëmshme në mbeturina, zvogëlimin e veçorive të rrezikshme dhe zvogëlimin e sasisë dhe masës vëllimore të mbeturinave.</p> <p>4. Ndalohet hollimi i mbeturinave të rrezikshme, me qëllim të shkarkimit të tyre në mjedis, përveç në rastet kur lejohet nga Ministria.</p> <p>5. Ministria, me akt nënligjor, përcakton vlerat kufitare të përqendrimeve për komponentët e rrezikshme në mbeturina, sipas nenit 7 paragrafit 6. nënparagrafi 6.5. dhe 6.6. të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 36 Dokumentet përcjellëse gjatë bartjes së mbeturinave</p> <p>1. Bartja e mbeturinave deri në destinacionin e caktuar përcillet me dokumente të veçantë përveç mbeturinave komunale nga amvisëritë.</p> <p>2. Prodhuesi apo zotëruesi i mbeturinave, duhet të ruaj një kopje të dokumentacionit përcjellës të mbeturinave të vërtetuar me shënimet e pranuesit të mbeturinave.</p>	<p>reduce the concentration of harmful components in waste, reduce hazardous characteristics and reducing the quantity, volume and mass of waste.</p> <p>4. Prohibited is the slimming of hazardous waste, in order to discharge into the environment, unless permitted by the Ministry.</p> <p>5. Minister, by sub-legal act, establishes the limited values for concentrations of hazardous components in waste, according to article 7 paragraph 6. subparagraph 6.5. and 6.6. of this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 36 Accompanying documents of the waste transfer</p> <p>1. Transfer of wastes from one country to another country, to a certain destination should be followed by separate document except by municipal households waste.</p> <p>2. Waste producer or holder must keep a copy of accompanying documentation of waste and paper meet with the recipient's records on waste.</p>	<p>samanjivanja koncentracije opasnih komponenata otpada i smanjivanje količine i obima otpada.</p> <p>4. Zabranjeno je razblaživanje opasnog otpada radi ispuštanja u životnu sredinu, osim u slučajevima kada je dozvoljeno od Ministarstva.</p> <p>5. Ministar, podzakonskim aktom, određuje granične vrednosti koncentracije opasnih komponenti u otpadu, prema članu 7 stav 6. podstav 6.5. i 6.6. ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 36 Dokument o praćenju tokom prevoza otpada</p> <p>1. Prevoz otpada do određene destinacije obavlja se posebnim dokumentima osim komunalnog otpada iz domaćinstva.</p> <p>2. Proizvođač ili vlasnik otpada, treba da čuva kopiju overenog popratnog dokumenta o otpadu sa podacima o primaocu otpada.</p>
---	---	--



<p>3. Kur prodhuesi apo zotëruesi i mbeturinave, në afat prej 30 ditë nuk e pranon dokumentin e vërtetuar nga pranuesi i mbeturinave, është i detyruar të inicioj procedurën e verifikimit për qarkullimin e mbeturinave si dhe të njoftojë menjëherë autoritetin kompetent.</p> <p>4. Prodhuesi apo zotëruesi i mbeturinave, është i detyruar ta ruajë dokumentin përcjellës për bartjen të mbeturinave të rrezikshme, së paku pesë (5) vjet.</p> <p>5. Përmbajtja, forma dhe mënyra e plotësimit të dokumentacionit përcjellës për mbeturinën është përcaktuar në Shtojcën V. të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 37 Dokumenti përcjellës për mbeturinat e rrezikshme</p> <p>1. Bartja e mbeturinave të rrezikshme përcjellët me dokument të veçantë.</p> <p>2. Qeveria, me akt nënligjor sipas nenit 35 paragrafi 2, të këtij ligji përcakton përmbajtjen, numrin e kopjeve të dokumentit nga paragrafit 1. të këtij neni, procedurën e pranimit dhe dorëzimit të mbeturinave të rrezikshme nga personat kompetent.</p>	<p>3. When the waste producer or holder, within 30 days will not receive the document completed by the recipient of the waste is required to initiate the verification procedure for movement of waste and immediately notify the competent authority.</p> <p>4. Waste producer or holder is obliged to keep the accompanying document for the transfer of hazardous waste, at least five (5) years.</p> <p>5. Content, form and ways of implementing the document for accompanying the waste is defined in Annex V. of this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 37 Accompanying document of hazardous waste</p> <p>1. Transfer of hazardous waste is accompanied by special document.</p> <p>2. The Government, by sub-legal act in accordance Article 35 in this law determines content, number of copies of the document under paragraph 1. of this article, the procedure for acceptance and delivery of hazardous waste by competent persons.</p>	<p>3. Kada proizvođač ili vlasnik otpada, u roku od 30 dana ne primi primerak overenog dokumenta od primaoca otpada, obavezan je da pokrene postupak provere o kretanju otpada i bez odlaganja obavesti nadležni organ.</p> <p>4. Proizvođač ili vlasnik otpada, dužan je da čuva kompletirani dokument o kretanju otpada najmanje pet (5) godine.</p> <p>5. Sadržaj, obrazac i način popunjavanja dokumenta o kretanju otpada propisan je u Dodatku V. ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 37 Dokument o praćenju opasnog otpada</p> <p>1. Kretanje opasnog otpada prati se posebanim dokumentom.</p> <p>2. Vlada, podzakonskim aktom prema članom 35, stavom 2, ovog zakona utvrđuje, sastav, broj kopija dokumenta iz stava 1. ovog člana, proceduru primopredaje opasnog otpada od nadležnih lica.</p>
--	--	---



Neni 38 Administrimi i mbeturinave te veçanta	Article 38 Management of specific waste	Član 38 Upravljanje posebnim otpadom
<p>1. Administrimi i mbeturinave te veçanta nga neni 4. paragrafi 1. nënparagrafi 1.15. i këtijë Ligji, bëhet sipas metodave, të cilat nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.</p> <p>2. Ministri ndërmerr masa shtesë për administrimin e mbeturinave të veçanta, nëse mbeturinat dhe çfardo veprimi me mbeturina rrezikojnë mjedisin dhe shëndetin e njeriut.</p> <p>3. Qeveria është e detyruar të ndërmerr masa të shpejta për parandalimin e rrezikut, nëse vlerëson se ato mund të paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.</p> <p>4. Sipas këtij ligji mbeturinat e veçanta janë:</p> <p>4.1. vajrat e përdorura dhe mbeturinat me vajra;</p> <p>4.2. bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar;</p> <p>4.3. gomat e vjetra dhe të shpenzuara;</p>	<p>1. Management of specific waste under article 4. paragraph 1. subparagraph. 1.15. of this Law, is organized by methods, through which there is no risk for human health and the environment.</p> <p>2. Minister may undertake additional measures for the management of special wastes, if waste and all waste operations may endanger human health and the environment.</p> <p>3. The Government is obliged to undertake quickly measures for risk prevention, if this case can be presented estimated risk to human health and the environment people.</p> <p>4. According to this law the special wastes are:</p> <p>4.1. used oils and wastes with oils;</p> <p>4.2. batteries and spent accumulators;</p> <p>4.3. old tires and spent;</p>	<p>1. Upravljanje posebnim otpadom iz člana 4. stav 1. podstav 1.15. ovog Zakona, vrši se metodama, koje ne predstavljaju opasnost za životnu sredinu i zdravlje ljudi.</p> <p>2. Ministar preduzima dodatne mere za upravljanje posebnim otpadom, ako otpad i bilo koj aktivnost sa otpadom ugrožavju životnu sredinu i zdravlje ljudi.</p> <p>3. Vlada je dužna da preduzima hitne mere za sprečavanje opasnosti, ako proceni da one mogu predstaviti opasnost za životnu sredinu i zdravlje ljudi.</p> <p>4. Prema ovom zakonu poseban otpad je:</p> <p>4.1. upotrebljeno ulje i otpad od ulja;</p> <p>4.2. baterije i korišćeni akumulatori;</p> <p>4.3. stare i korišćene gume;</p>



4.4. mbeturinat nga ambalazhet dhe paketimet;	4.4.waste of labeling and packaging waste;	4.4.otpad od ambalaža i paketiranja;
4.5. mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike;	4.5. waste from electrical and electronic equipment;	4.5.otpad od električne i elektronske opreme;
4.6. gypat fluoroshent të cilët përmbajnë merkur;	4.6. fluoroshent pipes that contain mercury;	4.6.fluoroscetne cevi koji sadrže živu;
4.7. mbeturinat që përmbajnë PCB dhe PCT;	4.7. waste containing PCB and PCT;	4.7.otpad koji sadrži PCB i PCT;
4.8. mbeturinat që përmbajnë azbest;	4.8. wastes containing asbestos;	4.8.otpad koji sadrži azbest;
4.9. automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre;	4.9. thrown vehicles and their wastes;	4.9.bačena vozila i njihov otpad;
4.10. mbeturinat nga demolimi dhe konstruktimi i objekteve ndërtimore;	4.10.mbeturinat from demolition and construction of building facilities;	4.10.otpad od demoliranja i konstrukcija građevinskih objekata;
4.11. mbeturinat biodegraduese;	4.11. biodegrading waste;	4.11.biodegradivni otpad;
4.12. mbeturinat medicinale dhe veterinare;	4.12. medical wastes and veterinary;	4.12.medicinski i veterinarski otpad;
4.13. mbeturinat që përmbajnë materje organike të qëndrueshme ndotëse;	4.13. waste containing Sustainable Organic Substances of pollutants;	4.13. otpad koji sadrži održive zagađujuće organske otpadne materije;
4.14. mbeturinat nga prodhimtaria e dioksidit të titanit;	4.14.waste from the titanium dioxide production;	4.14.otpad proizvoden od titan dioksida;



<p>4.15. mbeturina të lymit nga trajtimi i Ujrave.</p> <p>4.16. mbeturinat nga industria ekstraktive dhe minierave - mbeturinat, që krijohën gjatë hulumtimeve, nxjerrjes, trajtimit dhe magazinimit të resurseve minerale dhe nga aktiviteti i eksploatimit të gurit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 39 Administrimi i vajrave të përdorura dhe mbeturinat me vajra</p> <p>1. Personat që administrojnë vajrat mbeturinë dhe mbeturinat me vajra janë të pajisur me licencë.</p> <p>2. Është e ndaluar që vajrat mbeturinë të derdhen në tokë, ujë, në rrjetin e ujrave të zeza, të magazinohen ose deponohen në vende të papërshtatshme dhe të përpunohen në pajisje të cilat ndotin ajrin, ujin dhe tokën.</p> <p>3. Prodhuesit e vajrave mbeturinë janë të detyruar të sigurojnë dorzimin e mbeturinave personave të licencuar për administrimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinave me</p>	<p>4.15. silt waste of the water treatment.</p> <p>4.16. Waste from extraction industry and mining - waste created during the research, extraction, treatment and storage of mineral resources and the exploitation of stone activity.</p> <p style="text-align: center;">Article 39 The management of oils waste and wastes with oils</p> <p>1. Persons that manage the oils waste and waste with oils must be licensed.</p> <p>2. It is prohibited to discharge waste oils or release to soil, water, the sewage system, stored or disposed of in inappropriate places, mixing of waste oils in the collection of hazardous waste oils and to be processed in the device from which comes to the air pollution, ground and water.</p> <p>3. Producers of oil waste are required to ensure the delivery to licensed persons for management of the oil wastes and waste with oils.</p>	<p>4.15. otpad od mulja nastalog tretiranjem vode.</p> <p>4.16. otpad od ekstraktivne industrije i rudarstva – otpad nastalih tokom istrazivanja, i vadjenja,, tretmana i skladistenje mineralnih resursa i aktivnosti za eksploatacija kamena.</p> <p style="text-align: center;">Član 39 Upravljanje upotrebljenih ulja i otpadom sa uljama</p> <p>1. Lica koji rade otpadnim uljima trebaju biti licencirani.</p> <p>2. Zabranjeno je ispuštanje otpadnih ulja u zemlji, vodu, mreži crnih voda , skladištenje ili deponovanje na nepogodnim mestima, i prerade u opremi zagađuje vazduh, vodu i zemljišta.</p> <p>3. Proizvođač otpadnog ulja dužan je da obezbedi predaju otpada licima licenciranih za upravljanje upotrebljenih ulja i otpada od ulja.</p>
---	--	---



<p>vajra.</p> <p>4. Personat që mbledhin, magazinojnë dhe trajtojnë vajrat e përdorura dhe mbeturinat me vajra, duhet të mbajnë evidencën për to dhe shenimet sipas afatit ligjorë t'i dorëzojnë në Ministri.</p> <p>5. Mbeturinat e vajrave ushqimore duhet të mblidhen, grumbullohen dhe t'i dorëzohen personit të licencuar për përpunimin dhe trajtimin e tyre.</p> <p>6. Ministria, me akt nënligjor, përcakton kushtet dhe rregullat për administrimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinat me vajra.</p> <p style="text-align: center;">Neni 40 Administrimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore</p> <p>1. Personat të cilët administrojnë mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore duhet të jenë të licencuar.</p> <p>2. Në bazë të dispozitave të këtij ligji, dhe akteve tjera, komunat caktojnë lokacionin për deponimin dhe nxjerrin rregulla për mënyrën e administrimit të mbeturinave nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore në teritorin e tyre.</p>	<p>4. Persons that collect, treat, and storage the oils waste, must keep records on waste and notes under the legal deadlines that will present to the Ministry.</p> <p>5. Food waste oils must be collected, gathered and delivered to a licensed person for their process and treatment.</p> <p>6. Minister, by sub-legal act, determines the conditions and rules for the management of oils waste and waste with oils.</p> <p style="text-align: center;">Article 40 Management of Waste from construction and demolition of the building facilities</p> <p>1. Persons that manage the wastes from building construction and demolition facilities must be licensed.</p> <p>2. According to the provisions of this law, and other legal acts municipalities determine the storage location and set out the rules about the management of waste from facilities construction and demolition in their territory.</p>	<p>4. Lica koja sakupljaju, skladište i tretiraju upotrebljena ulja i otpad od ulja, treba da vode evidenciju o njima i podatke prema zakonskom roku dostave Ministarstvu.</p> <p>5. Jestivo otpadno ulje treba sakupljati, nagilovaju i dostaviti licenciranom licu za njihovu preradu i tretman.</p> <p>6. Ministar, podzakonskim aktom propisuje uslove i pravila za upravljanje upotrebljenih ulja i otpada od ulja.</p> <p style="text-align: center;">Član 40 Upravljanje otpadom od gradnje i demoliranja građevinskih objekata</p> <p>1. Lica koja upravljaju otpadom od gradnje i demoliranja građevinskih objekata trebaju biti licencirana.</p> <p>2. Na osnovu odredaba ovog zakona, i drugih akata, opštine određuju lokaciju za skladištenje i donose pravila o načinu upravljanja otpadom od gradnje i demoliranja građevinskih objekata na njihovu teritoriju.</p>
---	--	--



<p>3. Ministria me akt nënligjor, përcakton kushtet e përgjithshme dhe rregullat për administrimin mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.</p> <p style="text-align: center;">Nenin 41 Administrimi me Bateritë dhe akumulatorët mbeturinë</p> <p>1. Personat të cilët administrojnë bateritë dhe akumulatorët mbeturinë duhet të jenë të licencuar.</p> <p>2. Prodhuesit dhe importuesit e baterive dhe akumulatorëve si dhe pajisjeve për mbajtjen dhe vendosjen e tyre janë të detyruar të vendosin udhëzimet të cilat përbajnë klasifikimin në lloje, përmbajtjen e metaleve të rënda dhe mundësinë e riciklimit ose magazinimit.</p> <p>3. Prodhuesit dhe importuesit e baterive dhe akumulatorëve janë të detyruar të mbajnë dhe ruajnë evidencën për sasinë e prodhuar apo importuar të tyre.</p> <p>4. Prodhuesit dhe importuesit e baterive dhe akumulatorëve janë të detyruar të dorzojnë bateritë dhe akumulatorët mbeturinë, në vende të caktuara ose vetëm te personat e licencuar.</p>	<p>3. Minister by sub-legal act, defines the general conditions and rules for managing waste of facilities construction and demolition.</p> <p style="text-align: center;">Article 41 Management by Batteries and accumulators wastes</p> <p>1. Persons who manage waste batteries and accumulators must be licensed.</p> <p>2. Manufacturers and importers of batteries and battery equipment for their maintenance and deployment are obliged to draft on guidelines for classifying species, heavy metal content, and the possibility of recycling or storage.</p> <p>3. Manufacturers and importers of batteries and accumulators are required to keep and maintain records on the produced or imported quantity.</p> <p>4. Manufacturer and importer of batteries and accumulators are required to deliver the waste batteries and accumulators in certain locally or to the licensed persons only.</p>	<p>3. Ministar podzakonskim aktom, utvrđuje opšte uslove i pravila za upravljanje otpadom od gradnje i demoliranja građevinskih objekata.</p> <p style="text-align: center;">Član 41 Upravljanje Otpadom od baterija i akumulatora</p> <p>1. Lica koja upravljaju otpadom od baterija i akumulatora trebaju biti licencirani.</p> <p>2. Proizvođač i uvoznik baterija i akumulatora i opreme za njihovo održavanje i ugrađivanje dužni su da postave uputstva koja sadrže klasifikaciju prema vrsti, sadržaju teških metala i mogućnosti ricikliranja ili skladištenja.</p> <p>3. Proizvođači i uvoznici baterija i akumulatora dužni su da vode i čuvaju evidenciju o proizvodnji ili uvezenoj količini.</p> <p>4. Proizvođači i uvoznici baterija i akumulatora dužni su da predaju baterije i akumulatore otpad na određenim mestima ili samo licenciranim licams.</p>
--	--	---



<p>5. Ministria me akt nënligjorë, përcakton përmbajtjen dhe formën e shenjave për bateritë dhe akumulatorët mbeturinë, limitet për komponentat e dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut si dhe mënyrën e administrimit.</p>	<p>5. Minister by sublegal acts act defines content, and the form of signs for waste batteries and accumulators, limits for components that are harmful for environment and health and the manner of administration.</p>	<p>5. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje sadržaj i obrazac oznaka za otpad od baterija i akumulatora, ograničenja za štetne komponente po životnu sredinu i zdravlje ljudi i način upravljanja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 42 Administrimi i gomave jasht përdorimit dhe mbeturinat e gomës</p>	<p style="text-align: center;">Article 42 Management of used tires and scrap rubber</p>	<p style="text-align: center;">Član 42 Upravljanje gumama van upotrebe i otpada od gume</p>
<p>1. Personat që administrojnë gomat jashtë përdorimit dhe mbeturinat e gomës, duhet të jenë të licencuar.</p> <p>2. Prodhuesi dhe importuesi i të gjitha llojeve gomave duhet të mbaj evidencën për sasinë e prodhuar dhe importuar.</p> <p>3. Zotëruesi i gomave jasht përdorimit dhe mbeturinave të gomës duhet të mbaj evidencën, dhe shenimet për llojin dhe sasinë e mbledhur, trajtuar dhe deponuar si dhe t'i ruaj ato.</p> <p>4. Shenimet nga paragrafi 2. dhe 3. i këtij neni, i dërgohen Ministrisë.</p> <p>5. Ministri me akt nënligjor përcakton mënyrën e administrimit të gomave jasht përdorimit dhe mbeturinave nga goma .</p>	<p>1. Persons, who manage waste tires and tires out of use, must be licensed.</p> <p>2. Manufacturer and importer of et all type rubber / tires must keep records on the amount of produced and imported.</p> <p>3. Holder of old tires, used tires and waste out of rubber shall keep and maintain records on the type and amount collected, handled and stored.</p> <p>4. Notes from paragraph 2 and 3. of this article, shall send to the Ministry.</p> <p>5. Minister by the sublegal act determines the manner of administration of the tires out of use and waste rubber.</p>	<p>1. Lica koja upravljaju gume van upotrebe i otpad od guma, trebaju biti licencirani.</p> <p>2. Proizvođač i uvoznik svi vrsta guma treba da vodi evidenciju o proizvedenoj i uvezenoj količini.</p> <p>3. Vlasnik starih guma, neupotrebljivih guma i otpadnih guma treba da vodi i čuva evidenciju i podatke o vrsti i sakupljenoj količini, tretiranoj i skladištenoj količini.</p> <p>4. Podaci iz stava 2 i 3. ovog člana, dostavljaju se Ministarstvu.</p> <p>5. Ministar podzakonskim aktom određuje način upravljanja neupotrebljivim gumama i otpadom od guma.</p>



Neni 43 Administrimi i mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike	Article 43 Management of Waste from electrical and electronic equipment	Član 43 Upravljanje otpadom od električnih i elektronskih proizvoda
